



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 5.12.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), Tush Markaj-Bordi, media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.11.2011,**
3. **Caktimi i ekspertit për p/l për mbeturina,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe me disa shtesa në pikën e fundit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.11.2011.

3. Caktimi i ekspertit për “Mbeturina”

Kryetari Nait Hasani rikujtoi anëtarët e komisionit për punën e GP lidhur me projektligjin për mbeturina dhe dëgjimin e mbajtur publik, për të cilin është kërkuar nga kryesia një muaj shtesë

për shqyrtim, ai njoftoi me CV e ekspertit të propozuar z. Behxhet Shala, ndërsa komisioni nxori :

V E N D I M

- I. **Behxhet Shala**, angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm rreth projektligjit për mbeturina në aspektin profesional.
- II. Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i komisionit që brenda dy ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

5. Të ndryshme

Në kuadër të kësaj pike **kryetari** vazhdoi temën rreth angazhimit të ekspertëve rreth projektligjeve në komision :

Projektligji për parkun e Sharrit dhe të Bjeshkëve të Nemuna

Rasim Demiri propozoi një ekspert më herët të propozuar (stafi kërkoi edhe një herë ta dërgoi propozimin).

Nijazi Idrizi tha se eksperti që do të angazhohet duhet të ketë parasysh se kemi të bëjmë me një “park të paqes” më herët të propozuar nga ekspertët e tri shteteve fqinjë : Mali Zi, Shqipëria dhe Kosova, pasi që ky park shtrihet në këto tri shtete, ndërsa për parkun e Sharrit gjithashtu duhet të vlerësohet bashkëngjitja e 26.000 ha nga Dragashi këtij parku. **Nait Hasani** sugjeroi të mbahen atje dy dëgjime publike (në Rugovë dhe në Dragash).

Liburn Aliu njoftoi komisionin lidhur me takimin në Pejë me REC ku u sqarua se ka mjaft probleme lidhur me parkun e “Bjeshkëve të Nemuna” ngase në atë rajon fshatarët mendojnë se ju cenohet pronësia, çka ky ligj nuk prek në atë fushë. Qeveria ia ka lënë punën më të komplikuar Kuvendit, vazhdoi, ngase komisioni duhet ti sqaroi ato probleme të cilat ata nuk i kanë sqaruar dhe është dashur ti sqarojnë gjatë verës në terren, përveç kësaj në këtë ligj implikohet edhe biznesi i prerjes së drunjve. Sa i përket idejës për “parkun e paqes” nuk e kundërshtoi por tha se është lënë anash çka edhe kjo tani i mbetet barë këtij komisioni.

Daut Haradinaj tha se personalisht është pjesë e lojërave politike që janë bërë deri tani në këtë rajon, ngase ai vet është pronarë i pasurisë pyjore në atë rajon deri te kufiri i Malit të Zi, ndaj tani konstatohet se duhet së pari të bëhet demarkacioni dhe definimi i pronës, ndërkaq problemi i prerjes së drunjve gjithmonë ka ekzistuar. Ai sugjeroi mos të ngutet komisioni ngase janë të pa zgjidhura çështjet serioze. Edhe ai u pajtua se duhet të sqarohet fakti me banorë që parku do të jetë mbrojtje e jo uzurpim prone, ngase 32 fshatra kanë prona në Rugovë.

Liburn Aliu sërish u fokusua në faktin se ky ligj nuk rregullon pronën por ende dominon logjika e vjetër tek popullata dhe pikërisht këtu qëndron problemi se popullatës nuk ju është sqaruar kjo çështje : mosprekja e pronës së tyre por mbrojtja e saj. **Nijazi Idrizi** u pajtua me këtë konstatim dhe insistoi që kjo duhet t’ju sqarohet banorëve se me këtë ligj do të janë përfitues.

Sevdije Lama konstatoi se në takimin e Pejës me REC nuk ishin prezent banorët, ndërsa **Liburn Aliu** këtë e pohoi dhe tha se pikërisht këtë do të ishte deshtë të bënte me banorë më herët ministria, e cila po propozon tani këtë ligj.

Afërdita Berisha konstatoi se me kesi lloj problemesh nuk kemi të bëjmë në projektin tjetër për Sharrin.

Tush Markaj nga bordi i mjedisit nuk kundërshtoi idenë për angazhimin e ekspertëve por duhet me sqarua dilemën se për çka duhet të bëhet ekspertiza. Ai mendon se duhet të angazhohet një jurist mjedisor, sidomos për Sharrin ngase atje mendohet se çfarëdo ligji për parkun mund të eliminoi drejtën e tyre për pronën. Në anën tjetër ai tha se është shumë e

rëndësishme vendimi politik ngase deri tani nuk ka qenë unike. Ai shprehu kënaqësinë se në këtë komision ka pajtim politik, por megjithatë shprehu brengosjen e cila do të hiqet vetëm nëse hartohet një kontratë ngjashëm me atë që ne e quajmë martesë, ngase shteti (ministria) me ligj duhet të lidhë këtë kontratë me banorët që bashkohet me ata por pa i dëmtuar aspak, përkundrazi.

Nait Hasani pas konsultimeve sugjeroi se për këto dy projekte nevojiten dy ekspertë : një jurist (mundësisht mjedisor) dhe një për pyje, për çka edhe komisioni u angazhua që pas leximit të parë të propozohen emrat e tyre.

Projektligji për fshatin Hoça e madhe

Liburn Aliu për këtë projektligj tha se duhet të dallojmë dy gjëra, njëra që i takon trashëgimisë dhe tjetra e zhvillimit rural e cila ka ndikuar që të sjellët ky projektligj, çka në thelb është defekt i këtij projekti. Ky fshat është zonë e mbrojtur me pakon e Ahtisarit dhe do të mjaftonte kaq, dmth zhvillimi rural është ajo që shtynë hartimin e projektligjit në fjalë. Për këtë arsye për këtë projektligj propozoi një ekspert jurist dhe urbanist. **Nijazi Idrizi** për të ndihmuar në sqarimin e kësaj çështje theksoi se ekziston PZHK (plani zhvillimor komunal) dhe PZHR (plani zhvillimor rural) që në këtë rast ia ka dhënë drejtën për të hartuar këtë projekt sipas z. Aliu, megjithatë u pajtua se duhet të angazhohen dy ekspertë, një për trashëgimi kulturore dhe tjetri për PZHR.

Në pyetjen e **Daut Haradinajt**, Liburn Aliu tha se është konsultuar me një ekspertë izraelitë që do të ishte absolutisht i paanshëm por i shtrenjtë, ngase ai nuk ka kundërshtuar asnjë konstatim të deritashëm të këtij komisioni. Edhe **Tush Markaj** u pajtua se planifikimi rural ja jap drejtën këtij projektligji të hartuar.

Projektligji për OMGJ

Kryetari Nait Hasani konstatoi se lidhur me këtë projektligj komisioni ka mbajtur takimet me ekspertin e kësaj lëmie z. Bajram Berisha i cili ka sugjeruar moskalimin në leximin e dytë ngase duhet të plotësohet. Komisioni në takimin e fundit lidhur me këtë projektligj, në praninë e këshilltares së ministrit të bujqësisë dhe ekspertit në fjalë, ka konstatuar pranimin deklarativ të ministrisë të faktit se duhet të kthehet projektligji dhe të gjendet një nga rajoni që do të ishte e kompletuar, mirëpo ende nuk ka mbërijt nga ministria asgjë me shkrim rreth tërheqjes së projektligjit, ndaj komisioni nxori :

V E N D I M

- I. Bajram Berisha** , angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm rreth projektligjit për Organizmat e Modifikuara Gjenetiksht (OMGJ) në aspektin profesional, i cili në bazë të konstatimeve nga takimet e mbajtura në këtë komision do të sjellë mendimin me shkrim-ekspertizën, si bazë për veprimin e mëtejshëm të komisionit rreth këtij projektligji.
- II.** Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i komisionit që brenda dy ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

Rasim Demiri në vazhdim , para se të shqyrtohet projektligji për **Agjencinë për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore**, parashtroi një pyetje si të veprohet në situatën e krijuar në doganat e Kosovës meqenëse kemi mall radioaktivë që ka hyrë më herët brenda në territorin e vendit tonë dhe malli që gjendet në doganë i cili poashtu gjysma është radioaktivë gjysma nuk është, por për shkak të mungesës së ligjit adekuat, asnjëra nuk lejohet të hyjë në Kosovë, por edhe është pengesa për shkatërrimin e tyre pikërisht për shkak të mungesës së ligjit (bëhet fjalë për filtrat e llambave vajgurorë).

Nait Hasani falënderoi për këtë ndërhyrje dhe konstatoi se komisioni në këtë drejtim më tepër nuk mund të veproi sesa lejohet me rregulloren e Kuvendit. Ai në vazhdim sqaroi se nga ambasada amerikane ka ardhur përgjigja pozitive lidhur me këtë projektligj që mund të procedohet më tutje në leximin e dytë :
Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET raporti me rekomandime i raportuesit Nait Hasani , i rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore me një sugjerim për stafin që të bashkëpunoj me kryetarin e komisionit dhe zyrtarët ligjor për shtimin e një klauzole në këtë projektligj me një amendament.

Kryetari Nait Hasani konstatoi se komisionit dhe grupit punues për VNM dhe VSM i janë dërguar përgjigjet nga MMPH në pyetësorin e parashtruar nga GP, ndaj ky grup mund të vazhdoi monitorimin duke ja dërguar këtë dokument komunave përkatëse.

Liburn Aliu në vazhdim kërkoi mbështetjen e komisionit sa i përket angazhimit të mëtejme në komision të ekspertit ligjor Arsim Avdijaj nga NDI, ngase me punën e tij, sidomos gjatë shqyrtimit të projektligjit për kadastër, ka treguar shembull të mirë të hulumtimeve ligjore, p.sh. ligji në fuqi për pyje duhet të hulumtohet para se të vjen projektligji që do të zëvendësoi atë.

Daut Haradinaj nuk kundërshtoi sugjerimin, ngase komisioni ka nevojë për hulumtime.

Nait Hasani nuk u pajtua pikërisht kur është fjala për kadastrën, ngase atëherë ky ekspert bashkë me Përparim Ahmetin ja kanë lënë shumë dilema komisionit, për të cilat komisioni u deshtë të marr barën dhe të vendosë, megjithatë nuk kundërshtoi që komisioni të debatoi rreth çështjeve të tilla në punën e mëtejme të komisionit.

Përfaqësuesja e OSBE propozoi mbështetjen për komisionin duke sugjeruar një ekspert për projektet e cekura në mbledhjen e sotme. **Kryetari** shprehu mirëseardhjen për propozime të tilla duke sugjeruar që ata të propozohen deri në mbledhjen e radhës, njëherit propozoi dhe ftoi anëtarët e komisionit të angazhohen rreth ndryshimeve që duhet të bëhen në Ligjin për Festat zyrtare duke mbledhur nënshkrimet.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani